

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "Mila Solar" Sh.p.k.

Sot më date 15 Shtator 2022, z. Saimir Musta, lindur ne Bulqize me 24.03.1991 me numer personal J10324071M ka vendosur të nënshkruajë Aktin e themelimit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti, së cilës i bashkëngjitet (më poshtë "Shtojca 1").

Neni 1 - Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është "Mila Solar" Sh.p.k.

Neni 2 - Selia

Selia e Shoqërisë është në Rrugen Aleksander Moisiu, Rezidenca Delta, Apartamenti 10, Tirane, Shqipëri.

Neni 3 – Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë do të jetë me një afat te pacaktuar.

Neni 4 — Objekti i shoqërisë

4.1 Shoqëria ka Për Objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda Ose jashtë territorit të Republikës Së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:

- a) Tregti me shumice e pakice e artikujve te ndryshëm;
- b) Import - eksport i mallrave industriale,
- c) Transport mallrash;
- d) Prodhim dhe tregtim te materialeve te ndertimit;
- e) Veprimtari ne fushen e perpunimit dhe perfundimit te materialeve me mall te porositesit;
- f) Punime artistike, qendistari, rrobaqepesi, bizhuteri;
- g) Aktivitet ne fushen e hoteleri turizmit, bar ,restorant;
- h) Ndertime civile dhe ekonomike, asfaltim rruges, punime mirembajtjeje, sinjalistike etj.

- i) Projektim, Ndertim dhe Instalim i impianteve te prodhimit te energjisë nga burime të rinovueshme.
- j) Tregetim mobiljesh, pajisjesh dhe mjetesht pune në sektorët e perpunimit bujqesor, agroperpunimit, restoranteve, hotelerive, etj.
- k) Tregtim I mekanikes bujqesore, dhe te gjitha mujeteve te punes ne bujqesi, zejтари, agroprodhim ferma etj.
- l) Shoqëria mund të kryej çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

Neni 5 — Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 Leke

5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, të nënshkruar, me vlerë nominale sipas kontributit te ortakut ne kapitalin themeltar te Shoqërisë.

Neni 6 - Kontributet

6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:

Ortaku themelues i shoqërisë nënshkruan nje kuote te plote te barabarte me 100% te kapitalit te shoqërisë.

Neni 7 — Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 — Administrimi

8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administrator i Shoqërisë ortakut themelues:

Z. Saimir Musta, lindur ne Bulqize me 24.03.1991 me numer personal J10324071M

8.2 Administratori do te ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nenit 14 të Statutit.

8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme Për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara Për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohen Për ndihmë të tretëve Ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.

8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër


detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

Neni 9— Gjuha

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 2 (2) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU THEMELUES

Saimir Musta

A handwritten signature in blue ink, reading "Saimir Musta". The signature is written in a cursive style and is positioned above a long, horizontal, wavy line that serves as a decorative flourish or underline.